

PËRMBLEDHJE E PUNIMEVE TË KONFERENCËS

“KONTABILITETI NË 100 VJETOR”

Prof. Dr. Jorgji Bollano
Kryetar i KKK

Tiranë, 19 Nëntor 2012

Në radhë të parë dua të falenderoj dhe njëherë për pjesëmarrjen tuaj në këtë Konferencë dhe për interesin që treguat. Pjesëmarrja juaj flet për vlerësimin që keni për Institucionin tonë dhe mbi të gjitha për respektin dhe dashurinë për profesionin e bukur dhe të vështirë të kontabilistit.

Referatet që u paraqitën trajtuan dimensionet e kontabilitetit si:

- a. Rregullator
- b. Edukues

dhe u evidentua qartë roli i KKK në:

- a. Zhvillimin e profesionit
- b. Bashkëpunimin me Ministrinë së Financës për përsosjen e legjislacionit dhe zbatueshmërisë së tij
- c. Fushën e Auditimit
- d. Përmirësimin e raportimit financiar në sektorin bankar dhe atë të Sigurimeve

Në referatet e mbajtura në këtë Konferencë u vu theksi në disa prej aritjeve dhe vështirësive të hasura në këto vite si dhe në paraqitjen reale të statusit që gëzon sot KKK. Në mënyrë të përmbledhur mund të rendis disa përfundime si më poshtë:

- ❖ Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, si i vetmi organizëm profesional, publik dhe i pavarur, mundi të realizojë me sukses në këto vite të tranzicionit të ekonomisë dhe të reformave në fushën e kontabilitetit, kalimin nga kontabiliteti i mbështetur në rregulla në kontabilitetin bashkëkohor të mbështetur në parime duke ndihmuar njësitë ekonomike të përmirësojnë Raportimin Financiar përmes:
 - a) Përmirësimit të SKK
 - b) Përkthimit në gjuhën shqipe të SNRF-ve
 - c) Përputhjes së legjislacionit vendas me atë të BE

- ❖ KKK dhe shoqatat profesionale kanë bërë një punë të vullnetshme dhe të kujdesshme për harmonizimin e kërkesave të kontabilitetit me ato ndërkombëtare në kuadër të një objekti botëror të lëvizshëm të raportimit financiar;
- ❖ Jo vetëm KKK por të gjithë ne të përfshirë në profesionin e kontabilistit duhet ti kushtojmë më shumë vend kujtesës historike të zhvillimeve të kontabilitetit dhe profesionistëve kontabël si edukatorët e parë të këtij profesioni;
- ❖ Të forcohet bashkëpunimi mes Organizmave Profesionalë dhe i del për detyrë KKK të angazhohet për të bashkëpunuar me to në idenë e krijimit të Forumit të Organizmave Profesionalë në fushën e kontabilitetit;
- ❖ Të forcohet bashkëpunimi me Qeverinë për përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor të raportimit financiar dhe auditimit dhe të harmonizimit të mëtejshëm të tij me legjislacionin e BE;
- ❖ Të punohet në drejtim të përmirësimit të praktikave studimore;
- ❖ Të rritet dhe forcohet roli i audituesit duke rritur ndjeshmërinë e publikut se auditimi nuk është një burokraci ligjore por një domosdoshmëri për rritjen e transparencës së raportimit financiar si kusht për cilësinë e vendimarrjes nga investitorët;
- ❖ a) Krijimi i urave të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve e sidomos në zbutjen e problematikave që vijnë nga sektori bankar dhe
b) Përfshirja e përfaqësuesve të sektorit bankar dhe sigurimeve në Komitetin e Përkthimit dhe Rishikimit në mënyrë që përkthimi i tyre të jetë profesional dhe konsistent
- ❖ Të punohet për përsosjen e sistemeve të informacionit kontabël në kuptimin e kombinimit të Kontabilitetit të Përgjithshëm me Kontabilitetin e Kostos

Duke mbyllur përfundimet e kësaj Konference, përgëzoj stafin mbështetës për punën e bërë në një kohë të kufizuar dhe me një buxhet modest, pasi vlerësoj se arriti të përgatisë një Konferencë që ia arriti qëllimit.

Së fundmi ju uroj Gëzuar 100 Vjetorin e Pavarsisë.